

RELACION

I PROJEKTLIGJIT “PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I.QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, është propozim i Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, bazuar në pikën 2 të nenit 100, të Kushtetutës dhe nenin 5 të ligjit nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Projektakti ka si qëllim të rishikojë dhe përmirësojë kuadrin e përgjithshëm rregullator për komunikimet elektronike, të përcaktuar me ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, me qëllim nxitjen e investimeve për rrjetet e komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta (VHCN), si ato me fibër optike, ashtu edhe ato wireless (5G). Projektligji rishikon rregullimet në fuqi, në lidhje me spektrin e frekuencave, regjimin e shërbimit universal, rregullat për mbrojtjen e konsumatorit, numeracionin dhe komunikimet e emergjencave, rregullat për aksesin dhe rregullimin e tregut në tërësi, bazuar në një rregullim më simetrik.

Ky projektligj synon të transpozojë Direktivën (EU) 2018/1972 të parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike”, që ka zëvendësuar paketën e direktivave të komunikimeve elektronike të vitit 2002 dhe 2009 dhe kodifikon në një dokument të vetëm të gjithë elementët e ndryshëm të ligjit, që përbëjnë Kornizën Rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike, si dhe riorganizon kuadrin rregullator të komunikimeve elektronike, në një mënyrë që arrin atë që duket të jetë një ekuilibër i ndryshëm politik, midis rëndësisë së ruajtjes së konkurrencës, nga njëra anë dhe nevojës për investime të mëdha, të cilat konsiderohen të nevojshme për të çuar përpara Strategjinë e Tregut të Vetëm Digjital.

Rregullimet aktuale në ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kanë nevojë të rishikohen në kontekstin e ndryshimeve të ndodhura në sektorin e komunikimeve elektronike, zhvillimeve të teknologjive digjitale, përfshirjes në rregullim dhe të aplikacioneve, apo shërbimeve të reja, që mundësojnë mjetet e komunikimit elektronik, bazuar në praktikën evropiane.

Hartimi i një projektligji të ri, del si nevojë e adresimit më mirë të problematikave të tregut, dhe përmbushjes së objektivave strategjike për një shoqëri gigabit, duke marrë në konsideratë ndryshimet e vazhdueshme të teknologjive. Projektligji synon gjithashtu të plotësojë rekomandimin e Progres Raportit të vitit 2021 të BE-së për Shqipërinë në kapitullin 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media”, për transpozimin e direktivës 2018/1972/EU.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji, është në përputhje me Programin Analitik të Akteve, të miratuar për vitin 2022, si dhe Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2022-2024.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Zhvillimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike, dhe ofrimi i shërbimeve përmes tyre, është sot një domosdoshmëri. Infrastruktura e rrjeteve broadband, është infrastrukturë e rëndësishme kritike, që mund të luajë një rol domethënës në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe social të vendit, si dhe për të shfrytëzuar fuqitë transformuese të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në të gjithë vendin.

Për rëndësinë që paraqet infrastruktura digjitale për zhvillimin e gjithë ekonomisë, në veçanti në erën e transformimit digjital, u miratua me VKM nr. 434 datë 3.6.2020, Plani i ri Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025, i cili ka përcaktuar si vizion: “Shqipëria me infrastrukturë digjitale broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit”. Për realizimin e këtij vizioni, përcaktohen këto objektiva strategjike të zhvillimit të Broadband:

- Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i qëndrueshëm i infrastrukturës broadband.
- Objektivi strategjik 2: Reduktimi i ndarjes digjitale dhe ofrimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse broadband.
- Objektivi strategjik 3: Rritje e kërkesës për zhvillimin e ekonomisë digjitale dhe një shoqëri Gigabit.

Projektligji synon pikërisht, që të mundësojë arritjen e objektivit strategjik për një shoqëri gigabit, përmes mundësisë të zhvillimit të rrjeteve me kapacitet shumë të lartë.

Miratimi i këtij projektligji parashikohet të ketë ndikim të rëndësishëm në lidhje me sigurimin e ofrimit/ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, duke promovuar përfitime të mëdha për përfituesit fundorë, përfshirë dhe ata me aftësi ndryshe.

Objektivi për ndërtimin e rrjeteve me kapacitete shumë të larta, është një nevojë për të gjitha zhvillimet e pritshme për ekonomine digjitale, si dhe përcaktimin e rregullave më të qarta për rrjetet e komunikimeve elektronike, të drejtat e përdorimit të frekuencave, apo burimeve të tjera fundore, mekanizmat e duhur institucionalë e rregullatorë, zvogëlimin e ndarjes digjitale, etj. Për këtë qëllim është i nevojshëm hartimi i një ligji të ri.

Rrjetet me shpejtësi të lartë, ndikojnë në ofrimin e shërbimeve tek familjet dhe bizneset që lidhen me aplikacione të tilla si “clouds computing”, si dhe në marrjen e shërbimeve të tjera që kërkojnë lidhje me gjerësi bande të lartë dhe/ose simetrike (të tilla si televizioni i gjeneratës së ardhshme, video-konferencat, edukimi, e-health dhe aplikacionet e monitorimit në distancë).

Plotësimi dhe rishikimi i kuadrit ligjor për rrjetet e komunikimeve elektronike sipas të Direktivës (EU) 2018/1972 të parlamentit Evropian dhe të Këshillit “për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike”, është parashikuar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2022-2024, Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve 2022 dhe Planin

Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020–2025, si dhe programin e qeverisë për zhvillimin digjital.

IV.VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, në përputhje me rendin juridik të brendshëm dhe propozohet me qëllim përmirësimin e pasurimit e kuadrit ligjor për komunikimet elektronike, bazuar në nevojat e tregut dhe reflektimin e zhvillimeve teknologjike.

V.VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji synon transpozimin e pjesëshëm të Direktivës (EU) 2018/1972 të parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike”.

Në mënyrë të përmbledhur, Direktiva 2018/1972/EU e cila do të transpozohet, ka për qëllim:

- Konsolidimin e një tregu të brendshëm në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, që rezulton në krijimin e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë, konkurrencë të qëndrueshme, ndërveprueshmëri të shërbimeve të komunikimeve elektronike, aksesueshmëri, siguri të rrjeteve e shërbimeve dhe përfitime të përdoruesve fundorë; dhe,
- Sigurimin e ofrimit në të gjithë BE-në, të shërbimeve me cilësi të mirë, të përballueshme, të disponueshme publikisht nëpërmjet konkurrencës dhe zgjedhjes efektive, për të plotësuar nevojat e përdoruesve fundorë, duke përfshirë ata me aftësi ndryshe, në mënyrë që të aksesojnë shërbimet njësoj me të tjerët etj.

Direktiva 2018/1972/EU, ka zëvendësuar paketën e direktivave të BE-së të vitit 2002 të amenduar në vitin 2009, si, Direktiva Kuadër (2002/19/EC), Direktiva e Autorizimeve (2002/20/EC), Direktiva e Aksesit (2002/21/EC) dhe Direktiva e Shërbimit Universal (2002/22/EC), të cilat janë aktualisht të transpozuar në mënyrë integrale në ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Bazuar në nenin 104 të MSA-së, Shqipëria ka detyrimin e përafrimit të legjislacionit të BE-së, për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.

Miratimi i këtij projektligji, adreson dhe rekomandimin e dhënë në Progres Raportin e BE-së për Shqipërinë në kapitullin 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media”.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ligji është i organizuar në 25 krerë dhe përmban gjithsej 193 nene. Projektligji ruan në tërësi strukturën e Direktivës 2018/1972/EU, Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike (EECC), dhe harmonizon rregullimet që mbarten nga ligji aktual për komunikimet elektronike, që parashikojnë rregullime në nivel kombëtar.

Në **Kreun e I**, *Dispozita të përgjithshme*, përcaktojnë qëllimin dhe objektivat e ligjit, fushën e zbatimit, përkufizimet e termave. Në objektivat e përgjithshëm politike të projektligjit, nënvizohet zhvillimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta, që përbën një risi në kuadrin e ri ligjor e rregullator për komunikimet elektronike dhe që

nënvizohet si një objektiv strategjik. Ky kre përmban gjithsej 7 nene ku përfshihen qëllimi, fusha e zbatimit dhe përkufizimet e termave dhe objektivat e përgjithshëm politike që janë në përfaqësim të plotë me nenet e direktivës.

Neni 5, i këtij Kreu, përcakton objektivat e përgjithshëm politik për zhvillimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, që përfshin promovimin e konektivitetit dhe aksesit në rrjete me kapacitete shumë të larta (VHCN), duke përfshirë rrjetet fikse, të lëvizshme, dhe wireless, për përdorim nga të gjithë qytetarët dhe biznesin. Impakti pritet të jetë krijimi i një mjedisi investimesh për të përshpejtuar shtrimin e fibrës optike në Shqipëri për ndërtimin e VHCN. Në objektivat e përgjithshëm politike, nënvizohet sigurimi i zbatimit të politikave për promovimin e lirisë së shprehjes dhe informimit, promovimin e larmisë kulturore, gjuhësore dhe shumëllojshmërisë së mediave. Ndërsa në nenin 7, jepen përcaktime të rëndësishme për politikën spektrale të harmonizuar me rregullimet ndërkombëtare dhe politikën e Bashkimit Evropian.

Në **Kreun e II**, *Organizimi institucional dhe funksionimi*, përfshihen 18 Nene, në të cilat përcaktohet kuadri institucional dhe autoritetet kompetente në sektorin e komunikimeve elektronike: ministrin përgjegjës për komunikimet elektronike, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) dhe Autoritetin e Medias Audiovizive (AMA) duke ruajtur te njëjtin rregullim që aktualisht kemi me ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Gjithashtu në këtë Kre, përcaktohen kompetencat e Ministrisë dhe të AKEP, duke ruajtur në tërësi kompetencat e politikëbërësit tek ministri dhe ato rregullatore të AKEP. Në lidhje me AKEP, nënvizohet pavarësia e organit rregullator, roli dhe kompozimi i Këshillit Drejtues, vendimmarrja dhe drejtimi, financimi, buxheti, parimet e aplikimit të tarifave administrative, pagesat që bëhen në AKEP, pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, pagesa për alokimin dhe përdorimin e numrave, serive të numrave dhe frekuencave, tarifën për të drejtat e përdorimit të spektrit të radios, tarifën për të drejtën e përdorimit të burimeve numerike, bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente dhe çdo gjë tjetër që ka lidhje me krijimin dhe mënyrën e funksionimit të AKEP si rregullator, bashkëpunimit të tij me institucionet e tjera dhe të Këshillit Drejtues të tij. Në lidhje me funksionimin e AKEP, projektligji synon rritjen dhe forcimin e pavarësisë së AKEP në përputhje me parashikimet e Direktivës së BE-së 2018/1972/EU. Në këtë Kre kemi transpozimin e neneve të Direktivës, nga Neni 5 -19.

Në **Kreun e III**, *Autorizimi i përgjithshëm*, i cili është organizuar në tri seksione, përfshihen 15 nene, ku parashikohen rregullat mbi autorizimin e përgjithshëm të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve, kushtet që i bashkëlidhen autorizimit të përgjithshëm dhe të drejtat e përdorimit të spektrit radio dhe burimeve të numeracionit, të drejtat dhe detyrimet për autorizimin e përgjithshëm.

Në tërësi rregullimet e paraqitura në këtë kre nuk kanë ndryshime të mëdha nga rregullimet në fuqi sipas ligjit nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Regjimi i autorizimit të përgjithshëm i prezantuar që në vitin 2008, me miratimin e ligjit nr. 9918/2008, dhe që shënonte një reformë të rëndësishme në tregun e komunikimeve elektronike pasi lehtësonte hyrjen në treg drejt liberalizimit të plotë të këtij tregu, ruhet në projektligjin e prezantuar me pak rregullime/përmirësime, që lidhen me zhvillimet në treg dhe reflektimin e plotë të parashikimeve të Kodit Europian të Komunikimeve Elektronike, Direktivës 2018/1972/EU. Ky kre është i organizuar në disa seksione, për një qartësim më të mirë të parashikimeve të regjimit të autorizimit të përgjithshëm dhe ndjek strukturën e Direktivës së BE-së 2018/1972/EU.

Në **Kreun e IV**, *Sigurimi i informacionit, anketave dhe mekanizmi i konsultimit*, përfshihen 9 nene që lidhen me detyrimet e sipërmarrësve dhe dhënien e informacionit tek AKEP ose ministri, në përmbushje të detyrave të tyre si dhe nga ana tjetër garantimin e proceseve të transparencës, konsultimeve me aktorët e ndryshëm etj. Në këtë kre transpozohen në mënyrë të plotë nenet 20-29 të Direktivës duke përfshirë dhe rregullimet e reja që lidhen me zhvillimet dhe rregullimet e pritshme, sikurse është parashikimi për kryerjen e vrojtimit gjeografik për rrjetet me kapacitete shumë të larta (VHCN), broadband. Kryeja e vrojtimit gjeografik parashikohet të kryhet nga AKEP, në bashkëpunim me ministrin dhe institucionet e tjera të lidhura sipas rastit brenda tre vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe lidhet ngushtë me zhvillimet e të ardhmes për arritjen e objektivave për një shoqëri gigabit. Qëllimi i këtij studimi është evidentimi i mbulimit gjeografik me rrjete të komunikimeve elektronike të shpejtësisë shumë të lartë dhe i nevojave për këto rrjete. Ky është proces që do të kryhet në mënyrë periodike dhe përbën një risi në rregullimet e sektorit të komunikimeve elektronike. Impakti i pritshëm është më shumë transparencë në lidhje me mbulim Broadband dhe VHCN, si dhe informim dhe vendime të duhura të rregullatorëve dhe institucioneve të ndihmës shtetërore. Pjesë e rëndësishme e këtij kreu janë parashikimet për konsultimet me grupet e ndryshme të interesit apo institucionet, si dhe mekanizmat alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatave.

Në **Kreun V**, *Caktimi i harmonizuar i spektrit radio*, përfshihen 2 nene që zbatohen kur Shqipëria të bëhet vend anëtar i BE-së dhe kanë të bëjnë me njoftimin tek Grupi Evropian i Politikave Spektrale (RSPG), dhe harmonizimin e caktimit të spektrit radio nga AKEP. Në këto nene janë transpozuar pjesërisht neni 35 i Direktivës dhe neni 36 i Direktivës së BE-së.

Në **Kreun VI**, *Proçedurat e harmonizimit*, që përfshin 2 nene, lidhur me kërkesat teknike për Rrjetet e Komunikimit Elektronik dhe Standardet. Në këtë Kre është transpozuar në mënyrë të plotë neni 39 i Direktivës të BE. Për rregullimeve në këtë nen promovohet zbatimi i standardeve ndërkombëtare në fushën e telekomunikacioneve me qëllim garantimin e ndërveprimit të rrjeteve dhe shërbimeve. Gjithashtu parashikohet ndërmarrja e veprimit rregullator me masa shtrënguese nëse ndërveprueshmëria e sistemeve apo shërbimeve nuk garantohej.

Në **Kreun VII**, *Siguria*, përfshihen tre nene, për sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve, me përcaktime për garancitë dhe sigurinë e furnizuesve dhe ofruesve të rrjetit, si dhe implementimi dhe dispozitat detyruese. Tek ky Kre janë përafuar në mënyrë të plotë neni 40 dhe 41 i Direktivës së BE. Gjithashtu me nenin 55, “*Garancitë dhe siguria e furnizuesve dhe ofruesve të rrjetit*” parashikohen disa masa për garantimin e sigurisë të ofruesve, furnizuesve të pajisjeve të rrjeteve 5G dhe rrjeteve të gjeneratës së ardhme.

Në **Kreun VIII**, *Rregullimi i të drejtës së kalimit*, përbëhet nga dy nene me dispozita për të drejtën e kalimit, bashkëpërdorimin e elementëve të rrjetit dhe faciliteteve shoqërore për ofruesit e rrjeteve të komunikimeve elektronike që synojnë transpozimin e neneve 43 dhe 44 të Direktivës 2018/1972/EU. Në formulimet e këtij kreu është mbajtur parasysh që rregullimet për të drejtën e kalimit janë pjesë e ligjit nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve të shpejtësisë së lartë dhe sigurimi i të drejtës së kalimit”.

Në **Kreun IX**, *Qasja në spektrin e radio frekuencave*, që përfshin 18 nene, të ndara në tri seksione të ndërlidhura: 1. Autorizimet 2. E drejta e përdorimit dhe 3. Proçedurat. Në seksionin e parë “*Autorizimet*”, përfshihen dispozita që saktësojnë kërkesat për alokimin dhe menaxhimin e spektrit, veprimet sipas kërkesës së tregut, kufizimet, përcaktimet për planin

për përdorimin e radiofrekuencave, autorizimet për përdorimin e spektrit, kushtet bashkëlidhur të drejtave individuale të përdorimit të spektrit. Seksioni i dytë, “E drejta e përdorimit” ka dispozita për procedurat e dhënies së të drejtave individuale të përdorimit të spektrit, kohëzgjatjen e këtyre të drejtave, rinovimin e autorizimit të radio-frekuencave, transferimin ose dhënien me qira të të drejtave individuale të përdorimit të spektrit dhe konkurrencën. Dispozitat e seksionit të tretë “Procedurat”, trajtojnë koordinimin në kohë për dhënien e spektrit dhe specifikisht për brezin 5G, procedurën për kufizimin e numrit të të drejtave të përdorimit që jepen përmes procedurës së tenderimit/konkurrimit publik. Në nenet e këtij kreu janë transpozuar në mënyrë të plotë nenet 45-55 të Direktivës së BE.

Në Kreun X, Vendosja dhe përdorimi i paisjeve të rrjeteve pa tel, përfshihen 3 nene që kanë të bëjnë me rregullimin e aksesit për rrjetet lokale radio në zona të vogla, shtrimin dhe operimin e pikave të aksesit wireless në zona të vogla (small area wireless access point), si dhe rregullime teknike për fushat elektromagnetike. Nenet 77, 78 dhe 79 të këtij kreu kanë transpozuar nenet 56-58 të Direktivës në mënyrë të plotë.

Në Kreun XI, Dispozitat të përgjithshme, parimet e aksesit, përfshihen dispozita që japin kuadrin e përgjithshëm për të drejtat e detyrimit e një sipërmarrësi për të negociuar për akses dhe interkoneksion. Me nenet e këtij kreu janë transpozuar nenet 59 dhe 60 të Direktivës së BE-së.

Në Kreun XII, Aksesi dhe interkoneksioni, janë të përfshira pesë nene që transpozojnë nenin 61 të Direktivës lidhur me kompetencat e përgjegjësitë e organit rregullator AKEP, në lidhje me sigurimin e aksesit dhe interkoneksionit. Në veçanti dispozitat parashikojnë që vendimet e AKEP merren kur kjo është e nevojshme, për sigurimin e lidhjes pikë fundore – pikë fundore të rrjetit, dhe për sigurimin e ndërveprueshmërisë së shërbimeve.

Në Kreun XIII, Analiza e tregut dhe fuqia e ndjeshme në treg, përfshihen pesë nene si dispozitat e përgjithshme, dispozitat për sipërmarrjet me fuqi të ndjeshme në treg, procedurat për identifikimin dhe përcaktimin e tregjeve, procedurat për analizën e tregut dhe dispozita mbi kontrollin e veçantë për sjelljet anti-konkurruese. Në këtë kreu kemi një transpozim të plotë të neneve 63-67 të Direktivës së BE-së, të cilat sjellim pak ndryshime nga rregullimet në fuqi sipas ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Në Kreun XIV, Detyrimet për akses ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, përfshihen 16 nene, të cilat parashikojnë: vendosjen, ndryshimin, ose heqjen e detyrimeve rregullatore për sipërmarrësit e shpallur me fuqi të ndjeshme në treg, rregulla për marrëveshjet për aksesin, detyrimin për transparencë, detyrimin për mosdiskriminim, detyrimin për ndarjen e llogarive, aksesin tek punimet civile, detyrimin për akses dhe përdorim të elementeve të rrjeteve specifike dhe faciliteteve shoqëruese, kontrollin e çmimit, trajtimin rregullator të elementeve të rrjeteve me kapacitet shumë të lartë, ndarjen funksionale, ndarjen vullnetare, procedurën e angazhimit, rregullimin në rastin e sipërmarrjeve që veprojnë vetëm në tregun e shitjes me shumicë, rregullat për rrjetet me kapacitet shumë të lartë etj. Neni 97 “Aksesi në punimet /inxhinierine civile” pritet të sjellë një impakt pozitiv në uljen e kostove të shtrimit të rrjetit, në veçanti ky impakt do të ndjehet tek operatorët e vegjël. Neni 106 “Sipërmarrje vetëm shumicë” që përmban një trajtim rregullator më të lehtë të modelit të shitjes vetëm me shumicë, do të ketë impakt, lehtësimin e mëtejshëm të rolit të këtyre operatorëve, në tërheqjen e investimeve afatgjata në ndërtimin e rrjeteve të shpjëtësisë së lartë. Gjithashtu rregullat e parashikuara për trajtimin rregullator të rrjeteve me kapacitet shumë të lartë (VHCN), si dhe mundësia e ofruar për të paraqitur

vetëangazhime për plotësimin, adresimin e çështjeve që analiza e një tregu përkatës identifikon, përbën një risi në rregullimin për sipërmarrjet e shpallura me fuqi të ndjeshme në treg. Dispozitat e këtij kreu nga neni 92 deri në nenin 108, kanë transpozuar në mënyrë të plotë nenet 68-82 të Direktivës 2018/1972/EU.

Kreu XV, Kontrolli rregullator i shërbimeve me pakicë, parashikon kontrollin rregullator për shërbimet me pakicë. Neni 109, i këtij kreu, parashikon mekanizmat e kontrollit për shitjes me pakicë që mund të zbatohen ndaj një sipërmarrësi të shpallur me fuqi të ndjeshme në treg, për tregjet gjeografike ose të përdoruesve fundorë, si dhe që ato nuk zbatohen kur ka konkurrencë efektive.

Në Kreun XVI, Detyrime të shërbimit universal, përfshihen 21 nene, nga neni 110 deri në 130 të cilat kanë transpozuar nenet 84 deri 92 të Direktivës 2018/1972/EU. Në këtë kre kemi përcaktime në lidhje me shërbimin universal, kërkesat për shërbimin universal, si: disponueshmëria e shërbimit universal, masa për përdoruesit me aftësi ndryshe, sigurimi i shërbimit universal, dispozita për një shërbim universal të përballeshëm, statusi i shërbimeve universale ekzistuese, kontrolli i shërbimeve, detyrimet për koston e shërbimit universal, financimi i këtij shërbimi, si dhe transparenca dhe shërbimet e detyrueshme shtesë. Në dallim nga kuadri ligjor e rregullator në fuqi, në lidhje me detyrimet e shërbimit universal, kemi disa risi, në veçanti lidhur me kërkesat për ofrimin e aksesit broadband.

Në Kreun XVII Burimet e numeracionit, përfshihen nenet 131 deri në 136 dhe kemi përcaktime për burimet e numeracionit; procedurën për dhënien e të drejtave të përdorimit të burimeve të numeracionit; numrat e shkurter “116000”, për fëmijët e humbur dhe linjat në ndihmë të fëmijëve; aksesin në numra dhe shërbime; procedurat që ndiqen në rast revokimi të vendimeve për alokimin e numrave dhe serive numerike, në përputhje me parashikimet e neneve 93 deri në 97, të Direktivës 2018/1972/EU.

Në Kreun XVIII, Të drejtat e përdoruesit fundor, përcaktohen të drejtat e përdoruesit fundor si: përjashtimi i mikrondërmarrjeve; mosdiskriminimi; ruajtja e të drejtave themelore; niveli i harmonizimit; kërkesat për kontratat; transparenca, krahasimi i ofertave, shërbimet e aksesit dhe shërbimet e komunikimit ndërpersonal; zgjatja e kontratës dhe përfundimi; ndryshimi i ofruesit dhe portabiliteti i numrave; implementimi i portabilitetit të numrave; rregulla në rastin e ofertave paketë (bundled offers); kërkesa për ofrimin e shërbimit përmes sistemit të paralajmërimit publik; aksesin ekuivalent dhe zgjidhjen alternative për përdoruesit fundorë me paafhtësi; parashikime për sigurimin e ndërveprueshmërisë së radiove të makinës dhe paisjen radio të konsumatorit; dispozita mbi facilitetet shtesë dhe regjistrimi i përdoruesit fundor. Dispozitat e këtij kreu që përfshijnë 19 nene, transpozojnë në tërësi nenet 98 deri 116, të Direktivës 2018/1972/EU.

Në Kreun XIX, Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësia, jepen dispozita për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë në komunikimet elektronike bazuar në direktivën 2002/58/EC për privatësinë e komunikimeve elektronike. Ky kre që përfshin 13 nene, mbetet pothuajse i pandryshuar nga rregullimet në ligjin ekzistues për komunikimet elektronike. Në nenet e këtij kreu përfshihen kërkesat për masat mbrojtëse; konfidencialitetin e komunikimit; të dhënat për trafikun e komunikimit; identifikimi i linjës thirrëse; të dhëna për vendndodhjen; rregulla për mbrojtjen e të dhënave për përdoruesin fundor. Gjithashtu parashikohet dhe ruajtja e të dhënave për qëllime të procedimeve penale, si dhe asgjësimi i të dhënave të ruajtura në përfundim të afatit ligjor.

Në Kreun XX, *Masat për mbrojtjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike* parashikohen rregulla për mbrojtjen e rrjeteve nga dëmtimet duke ruajtur dispozitat ekzistuese në ligjin e komunikimeve elektronike në lidhje me: ruajtjen e rrjeteve nga dëmtimet; e drejta për përdorimin e pronës publike dhe private; detyrimet e ndërmarrjeve për mirëmbajtje; dispozita për mbrojtjen e rrjetit prej dëmtimeve nga të tretët si dhe detyrime për ndërmarrjet e ndërtimit,

Kreu XXI, *Komunikimet elektronike në raste të veçanta,* përfshin tre nene lidhur me sigurimin e komunikimeve në situata të veçanta si në rastet e emergjencës, parashikimi i bashkëpunimit të ndërmarrjeve në raste specifike si dhe dispozita për vijimin e shërbimit universal në rastin e grevave. Rregullimet sipas këtij kreu ruajnë dispozitat ekzistuese të ligjit për komunikimet elektronike.

Në Kreun XXII, *Rregullimet për internetin e hapur,* përfshihen katër nene në lidhje për aksesin në një internet të sigurtë dhe të hapur, transparencën për sigurimin e aksesit në internetin e hapur, mbikëqyrja dhe implementimi i kërkesave ligjore, si dhe informacioni i kërkuar dhe kontratat. Këto rregullime bazohen në Rregulloren e BE-së për Internetin e Hapur.

Në Kreun XXIII, *Inspektimi, monitorimi i spektrit të frekuencave dhe kundravajtjet/sanksionet administrative,* parashikohen dispozitat për masat administrative, gjobat, llojet e tyre dhe mënyrat e llogaritjes bazuar dhe në rregullimet ekzistuese dhe adresimin e problematikave në zbatim të ligjit 9918/2008. Në këtë kre përfshihen nenet e Inspektimit, monitorimit të lidhura me përputhshmërinë e kushteve të autorizimit të përgjithshëm ose të drejtave të përdorimit për radiospektrin, për burimet e numeracionit, detyrimet specifike, si dhe e drejta për apelim duke përafuar plotësisht nenet 30 dhe 31 të direktivës së BE.

Në Kreun XXIV, *Dispozita shitesë,* parashikohen procedurat për identifikimin e tregjeve transkombëtare; procedura për identifikimin e kërkesës transkombëtare, tarifat e terminimit, si dhe bashkëpunimi me Agjensitë Evropiane dhe rishikime. Këto rregullime janë të adresuara për vendet anëtare të BE-së dhe zbatimi i tyre është në momentin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Në Kreun XXV, *Dispozita të fundit dhe kalimtare,* janë dispozita të fundit dhe kalimtare, në to parashikohet nxjerrja e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, dispozitat kalimtare dhe hyrja në fuqi e këtij ligji.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Dispozitat e këtij projektligji parashikojnë rregullime që shtrihen për pjesën politikëbërëse tek Ministri për Infrastrukturën dhe Energjinë dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare si organi rregullator, mbikqyrës i sektorit të komunikimeve elektronike. Megjithatë rregullimet e këtij projektligji shtrihen dhe kanë pikëprerje dhe me institucione të tjera brenda fushës së tyre të përgjegjësisë. Gjithashtu dispozitat e këtij ligji parashikojnë rregulla që duhen zbatuar nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, operatorët e telekomunikacioneve që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike dhe shërbime të komunikimeve elektronike.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është përgatitur me asistencë teknike të Bashkimit Evropian, në kuadër të projektit Technical Assistance for The Telecommunications Sector, Specific Contract number: 300026749 — SIEA-2018-5578, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Projektligji ka kaluar në një proces të gjatë dhe të gjerë konsultimi me grupet e interesit, institucionet publike, ministrinë dhe Komisionin Evropian gjatë vitit 2022 dhe 2023. Projektligji në versionin e parë u prezantua në dy workshope të zhvilluara në datë 7 Korrik 2022, me institucionet publike dhe operatorët e tregut të komunikimeve elektronike. Për diskutimin e projektligjit janë zhvilluar disa tryeza konsultative me operatorët dhe institucionet e lidhura si më datë 19 shtator 2022 dhe me datë 22 nëntor 2022.

Projektligji u dërgua për mendim tek institucionet si dhe tek bashkitë për të cilat në projektligj ka parashikime që lidhen me fushën e tyre të përgjegjësisë. Projektligji “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” është konsultuar përmes regjistrit të konsultimeve publike në periudhën 31 tetor deri në 30 nëntor 2022. Në Regjistrin e konsultimeve publike nuk ka pasur komente të depozituara.

Gjatë procesit të konsultimit, janë paraqitur komente nga operatorët e komunikimeve elektronike të cilat janë konsideruar në tërësi në versionin e rishikuar të projektligjit në bashkëpunim me konsulentët. Gjithashtu janë konsideruar dhe reflektuar në tërësi në projektligj komentet e dhëna nga institucionet dhe ministrinë.

Projektligji për komunikimet elektronike, u përcoll pranë Komisionit Evropian përmes zyrës së Ministrisë të Shtetit dhe Kryenegociatorit me datë 8 mars 2023. Nga Komisioni Evropian u dërguan komente dhe vlerësime për projektligjin në datën 5 korrik 2023 dhe në 17 gusht 2023, të cilat janë reflektuar në draftin e ripunuar. Me datë 4 shtator 2023, nga Komisioni Evropian është kthyer përgjigje pozitive për versionin e ripunuar të projektligjit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji parashikon disa detyra shtesë për organin rregullator, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, po ashtu dhe për ministrinë përgjegjëse. Në lidhje me mbulimin e kostove për detyrat e reja të AKEP, ato do të jenë pjesë e planifikimit buxhetor të AKEP dhe do të mbulohen me të ardhurat e institucionit. Në lidhje me detyrat e ministrisë, ato do të përmbushen sipas parashikimeve në Planin Buxhetor Afatmesëm.